

INTERVISTË ME JAKUP QESHMEXHIUN

Prishtinë | Data: 12 janar, 2019

Kohëzgjatja: 74 minuta

Të pranishëm:

- Jakup Qeshmexhiu (I intervistuari)
- Aurela Kadriu (Intervistuesja)
- Donjeta Berisha (Kamera)
- Besarta Breznica (Kamera)

Simbolet e komenteve në transkriptë të komunikimi jo-verbal:

() - komunikim emocional

{ } - i intervistuari shpjegon me gjeste

Simbole të tjera në transkriptë:

[] - shtesë e tekstit për të lehtësuar kuptimin

Fusnotat janë shtesa editoriale që japin informacion mbi vendbanime, emra apo shprehje.

Pjesa e Parë

Aurela Kadriu: Kisha dashtë me fillu tu e prezantu ju vetëvetën...

Jakup Qeshmexhiu: Po...

Aurela Kadriu: Edhe me na tregu diçka për kujtimet e hershme të fëmijërisë t'juj. Domethanë, çka mbani në mend prej familjes? Prej vendit në të cilin jeni rritë? Qysh e mbani në mend fëmijërinë e juaj?

Jakup Qeshmexhiu: A do të filloj po?

Aurela Kadriu: Po.

Jakup Qeshmexhiu: Unë jom Jakup Qeshmexhiu. Jom i lindur me 11 mars, 1950 në Prishtinë jam i lindur. Shkollën fillore e kam kry në Shkollën fillore ish “Vuk Karadžić” tash është “Elena Gjikë”. Përndryshe, pjesën e dytë e kam krye në, atëherë ka qenë “Branislav Nušić” tash është “Gjergj Fishta” m’duket, me sa e di une. Shkollë... zanatin kom fillu 1964-tën si rrobaqepës kom fillue deri në vitin 1974. Atëherë isha punësu në ‘74-tën në Lotari të Kosovës. Në Lotari të Kosovës kom punu nja dymbëdhjetë vite, a trembëdhjetë. Edhe masanej u largova nga puna, fillova zanatin deri më edhe kësaj dite. Po në ndërkohë punova edhe në Teatrin Dodona, në Teatrin Dodona na erdhën masat e dhunshme, na largunë. Na largunë prej masave të dhunshme. Mbeta pa punë dhe fillova me punu çanta që s’e kom pasë as profesion as kurgjo. Qatëherë fillova dhe punova deri me ditën e sotit. Punoj edhe rrobaqepës edhe çanta-punues.

Prej familjes, baba m’ka lindë... veç të ardhun prej 1878-tës prej anës, që i thojshim prej Serbisë, prej Tavorlanit. Të shpërngulun pak në Drenicë, masandej ka ardhë ktu në Prishtinë si i ri. Veç e di që njo 140 vite jena në Prishtinë. Kom pasë babën nanën, gjyshën e kom pasë ma të vjetër. Edhe vllazni jemi katër, motra kanë qenë tri. E qishtu. Prej që ka mrri baba në Prishtinë si në moshën 18 vjeçare, 16 vjeçare në qat’ lagjen te parku atje, përmi furrë të Kacallarëve, qaty kemi nejt prej fillimit edhe sot e asaj dite aty jena gjithë. Prishtinën e mbaj në mend fort mirë se kom punu në ni Çarshi që as Bash Çarshia e Sarajevës nuk u kanë, as Bit Pazarit s’ka qenë ma i mirë se Çarshia jonë. Po,

fatkeqësisht në atë kohë qysh sundojke okupatori edhe shtike ka pak ka pak me rrxu e me hupë atë estetikë të qytetit tonë. Edhe arriti qëllimin, por ma shumë arritën qëllimin këta tonët.

Edhe kom punu zanatin prej moshës 14 vjeçare. Shkollën e mesme e kam krye ish “28 Nëntori” në shkollën e mesme të nxanësve në ekonomi. Këto rrugë kanë qenën kalldrëma. Kalldrëma e din çka domethanën? Me gurë kanë qenën. Rruga jonë ma ka qenë nihere krejt lloç atëherë, tani u shtru kalldrëm e prej kalldrëmit filloi jo apet gurë e asi... e tash u shtru me beton. Tash osht’ me beton veç sikur me kanë me guri, njejtë. Qyteti ka qenën, tash fakt që është ndërtu po larg, larg, larg ma i bukur u dokë atëherë se sa qitash. Po qe besa edhe njerëzit kanë qenë ma të mirë se qitash. Nuk ka pasë urrejtje njëri ndaj tjetrit.

Aurela Kadriu: E familja? Jeta juaj brenda shtëpisë qysh ka qenë? Qysh e mbani në mend?

Jakup Qeshmexhiu: Fort mirë ka qenën. Une veç në moshën 18 vjeçare jom martue. E kom pasun vëllaun e madh, qe besa motra e madhe u kanë e martume e tani vëllau i madh i martum, masandej m’u duft patjeter me u martu në moshën 18 vjeçare. M’i fali Zoti katër fmi, tre djem e ni vajzë. Deri në vitin 1994, në ‘94-tën më vdiq shoqja edhe u duft e u martova për herë të dytë. Jetesa ka qenë mirë. Babën e kom pasë si kryepunëtor të Ujësjiellit të Prishtinës, përndryshe edhe formulues i parë i Ujësjiellit të Prishtinës. Edhe vëllau i madh ka punu 50 vite në Ujësjiellës të Prishtinës.

Unë kom punue zanatin e ujësjiellit derisa jom hi... deri në vitin ‘68-‘69, tani e kom lanë fillova zanatin e rrobaqepësisë. Edhe ni motër e kom pasë para meje ajo u kanë e martume në Prizren, ni motër mas meje e martume në Prishtinë edhe dy vllaznia ma t’vogël janë kanë ktu në shkollën “Elena Gjika” te tonë. Prej 1939-tës e deri kësaj dite pa ni nxans kjo shkolla “Elena Gjika” të familjes tonë nuk ka mbetë kurrë, kurrë. Kurrë s’ka metën hiç. Edhe po thom e kemi njo mas njo krejt e kemi trashëgu këtë asi...

Knena ka qenën këto ndërtesa çka po i shihni, krejt në këtë rrugë çka janë kanë qenë krejt me qerpiq i thojshim ktyneherë ose tulla të papjekuna. Ka qenë nifarë kënaqësie me dalën. Tash i rrxun e i marun ndërtesa të reja po jo ashtu. Se unë kom qef atë metodën antike pak, e për qata mu s’po më kënaqin këto ndërtimet e reja.

Aurela Kadriu: Po më intereson, a ju ka tregu baba në cilin vit themelohet ujësjielli edhe çfarë ndërmarrje ka qenë? A ka pasë tregime prej babës t’juj?

Jakup Qeshmexhiu: Ajo ka qenë, niherë në fillim ka qenë ndërmarrje nën, nën... qysh me thonë, protektorat apo të Kuvendit të Komunës e masandej në vitin 19... m’duket se në vitin 1940 apo 1950 tani ish ndae. Së pari e ka pasë qitu ku është, se di a e dini, që është përballë Xhamisë së Madhe Hamami, qaty e kanë pasë punëtorinë. Une e mbaj në mend ata mirë si fmi shkojsha. Në anën tjetër përfundi ka qenë Hamami, a knena kanë qenë punëtorët edhe punëtorja e ujësjiellit.

Mas asajna dul... s’di sa vite punun qaty, tani dulën në kit’ pjesën që e ka televizioni i Prishtinës, mbrapa ish stacionit të autobusave. Qaty kanë qenë deri, vitin nuk p’e di. Tani kanë pasë dalën mbrapa tregut, osht’ ajo, ni ndërtesë që është e zejtarëve krejt. Mrapa tregut, reka ka qenë aty, lumi. Tani ma veç shkun atje edhe ku osht’ tash. Baba ka punu 47 vjet e shtatë muj në Ujësjellës të Prishtinës pa asni ditë pushim mjekësor. Pushim mjekësor i ka pasë qato tri javë që u smu edhe vdiq.

Vëllau ka punu 50 vite prej moshës nandë vjeçare, ai është i vitit 1942, prej moshës nandë vjeçare deri 50 vjet përvojë pune i ka bo në ujësjellës. E tash e kemi ujësjellësin trashëgimi krejt, baba, vëllau, une, vllaznia mas meje, djemtë e vllaznive. Djemtë e mi jo.

Aurela Kadriu: A është kjo arsyeja pse e keni mbiemrin Qeshmexhiu?

Jakup Qeshmexhiu: Arsyeja është se baba i ndjeri e ka pasë ni shok t’vetin, t’ndjerin bash qytetar të Prishtinës edhe ai ndër formuluesit e parë, e ka pasë emrin Ramiz mbiemrin. Se në atë kohë qyteti i Prishtinës është mbajtë gati si me turqeli edhe e ka pasë mbiemrin Qeshmexhiu 1937-tën ai ka shku për Turqi edhe ia ka lanë amanet babës me ia trashëgue mbiemrin edhe prej atëhershit na e kemi mbiemrin Qeshmexhiu.

Aurela Kadriu: Domethanë nuk lidhet najsen me faktin që baba ka qenë në ujësjellës?

Jakup Qeshmexhiu: Jo, në ujësjellës kanë punu edhe ai Qeshmexhiu në ujësjellës ka punu edhe ia ka lonë tani amanet masi po punon zanatin edhe Qeshmexhiu tash e kemi. Edhe jemi ni familje n’krejt Kosovën Qeshmexhiu na jemi. Çka kom mujtë me hasë në kufi të Maqedonisë kom hasë në ni kufitar kishte qenë maqedon tha, “Jemi si kusheri” tha, “Pse?” tha, “Unë jom Qeshmexhiev”. Qata, a për Bugari e di që ka qenë ni familje turke Qeshmexhiu. Tash varet, Qeshmexhiu te na është shqip, a makedonët i kanë thanë Qeshmexhiev a turqelitë i kanë thonë Qeshmexhi.

Aurela Kadriu: E qysh e keni pasë para Qeshmexhiu mbiemrin?

Jakup Qeshmexhiu: Aliu. Aliu e kemi pasën.

Aurela Kadriu: Nanën qysh e mbani në mend? Jetën brenda në shtëpi?

Jakup Qeshmexhiu: Nanën... e kom pasë ni nanë t’vogël, ni nanë t’mirë, ni nanë të kënaqshme. Baba ka qenë pak ma i mrrolshëm e me nanën e kemi pasë biseden ma t’mirë, ma të asi... se ka qenë shumë e afërt me neve. Mirë me nanën kaa qenë e Krajkovës, po të dalun te Hani i Dilit. Edhe ata janë para njiqind e kusur vjete këtu. Edhe deri në 1992 nana ka qenë gjallë, ‘92-tën veç ka pasë vdekë.

Aurela Kadriu: A keni jetu në shpi vetëm familja e ju? Domethanë, prindët edhe fmitë a keni jetu në bashkësi?

Jakup Qeshmexhiu: Po deri 1974-tën kemi jetu t'gjithë bashkë. Dihet për ato motrat që janë martu, ajo është tjetër. Veç krejt familja deri më 1974 kemi jetu bashkë. Në '74-tën une jom nda prej vllaznive e ka metë vëllau i madh edhe i vogël kanë metën në shtëpi. Tani në ndërkohë edhe vëllau i madh dul në shtëpi t'vet e kta t'voglit mbetën në shtëpi e qishtu.

Aurela Kadriu: Qysh ka qenë... qysh e mbani në mend qat' lagje? Meqenëse keni qenë qaty tonë jetën?

Jakup Qeshmexhiu: Lagjen, po të tregoj. Deri në 1956-tën tri familje kemi qenë shqiptare në atë lagje se krejt kanë qenën, tash po iu thojnë rom atëherë magjup na i thojshim. Krejt ka qenë magjup. E 1957-tën ka pasë ardhë ni familje prej Tuxhevcit, qaty afër kojshi. Me qata kom fillu me u shoqnu tani filloi për me u zgjonue me shqiptarë. Po është keq edhe me folën, po s'po ki qare pa folën. Masi erdhën shqiptartë filloi aty ni jo harmoni në atë lagje. Jo harmoni, pse? Vishin ndërtojshin e zgjenojshin oborrin e vet e ngushtojke rrugën.

Sot merre me mend qajo rruga jonë, ni kerr munet me kalue po me ardhë dy veç duhet me e lypë ni pjesë për me u largu e me u liru. Se na kemi lujtë, me magjup kur kemi lujtën kah nantë parë lujshim. Nantë ata, nantë na. Na lujshim futboll në qat' rrugë tash as kah katër vetë s'mun lujnë ma në atë rrugë. Veç e kanë ngushtu është katastrofë qysh u bo. Po atëherë, po thom, s'kemi pasë pushtet atëhere... se ky sistemi jonë ktu në Prishtinë, gjithkund edhe në Kosovë, niherë ma së pari kanë pasë turqit, serbët qe besa tani u asi, ua lejun turqëve, tani turqit edhe na diqysh e murem me shqiptarë. Po papë jemi kanë të shkelun. Po kur e muren kta tonët hala ma katastrofë, mos vet hiç.

Aurela Kadriu: E kur largohen romët prej asaj lagje?

Jakup Qeshmexhiu: Romët ia kanë nisë me u largue veç prej vitit 1957.

Aurela Kadriu: Pse?

Jakup Qeshmexhiu: Nuk kanë pasë presion. Po të tregoj që shumë ma mirë kemi kalu me qata rom që kanë qenë në atë kohë, se sa me do shqiptarë që kanë ardhë qitash qitu. Osht' për të ardhë keq se kjo po i bjen që po flas kundër kombit tem. Po çka është realiteti është qikjo. Realiteti është qikjo. Nuk e di a ishim t'nemum a e kemi nem vetëvetën, po më doket se kërkush s'na ka nem, vetëvetën e kemi nem e për qat' arsye. Po thom, fillun me u largu romët erdhën shqiptartë...

Aurela Kadriu: Për çfarë arsye po mendoni?

Jakup Qeshmexhiu: Vetëm për shkaqe ekonomike, presion s'ka pasun. Për shkaqe ekonomike kanë shkue. Do shkun në Banja Llukë, do kanë dalë në Kroaci e do kanë shku në Slloveni e Itali qe besa. Veç asnjë nuk ka dalë prej presionit. Prej presionit kanë dalë qatëherë mas luftës. Kjo pjesa tjetër e rrugës prej presionit kanë dalën. Jom dëshmitar i gjallë se tanë kohën e bombardimit këtu kom nejtën edhe e di. S'muj me mohue qata që e kom pa. Prej presionit... që mu m'u ka dashtë vet m'i ndihmu tri familjes, magjupve, se ata i kanë ndihmu ni kojshisë tem edhe une i kom ndihmu atyne prej shqiptarëve. Veç janë largue, janë largue prej presionit. A para luftës nuk ka pasë... nuk ka pasë kërkush kushte ma të mira p'i magjupve në krejt Europën. Në krejt Europën kushtet ma t'mira i kanë pasë magjuptë.

Aurela Kadriu: A i mbani në mend shpërnguljet e vitit, domethanë fundin e viteve të '50-ta fillimin e viteve të '60-ta nëpër Turqi? Prej asaj lagje e di që kanë shku shumë.

Jakup Qeshmexhiu: Po, 1956 unë isha në moshën gjashtë vjeçare. Mu çika e mixhës me familje krejt m'dulën në Turqi. Letrat na i kanë ndreqë masi kanë shku atje, letrat na i kanë ndreqë i thojshin ktyneherë Vesikat, na i kanë ndreqën letrat edhe na i kanë prue. Fatbardhësisht, tash s'e di, po më doket mu fatkeqësisht po thom se me pasë shku atje me siguri ma mirë kisha kalu sesa me qit' popullin tem qitash qitu.

Vëllau i madh kambngulën me gjithë motrën e madhe edhe nuk dulëm. Se sigurisht t'ishim shku atje, garant ishim asimilu qashtu qysh janë asimilu krejt edhe na ishim asimilu. Sa i përket për asimilim jom i kënaqun që kom nejtën, e sa për tjera s'kom çka me thanën. E kom pa, po thom kanë dalën, prej lagjes tonë kane dalë s'di sa familje. Qajo çika mixhës e do tjerë e krejt shkojshin qatje. Dikush ka shku prej presionit se në atë kohë veç i lypshin armtë prej shkijeve. Bile bash dhandrri jonë, qiky burri çikës t'mixhës s'ka pasë qare se gati çdo natë u dufke me u lajmëru në polici edhe iku shkoi.

Aurela Kadriu: A keni pasur ju presion gjatë aksionit të armëve?

Jakup Qeshmexhiu: Jo. Jo se kanë pasur interes prej babës tem për ujë të qytetit e për qat' arsye s'kanë bo presion. Qe besa e ka kqyrë mjeshttrinë e vet, punën e vet, familjen e vet e nuk ka asi... po, jo, jo nuk ka pasur presion. Unë po flas për familjen teme, se ka pasur interes qyteti për babën tem e për qat' arsye se kanë ngucë as s'na kanë ngucë neve.

Aurela Kadriu: Qysh e mbani në mend shkollën fillore? Në cilin vit keni shku?

Jakup Qeshmexhiu: Shkollën fillore... 1957-tën kam shku në klasë të parë qitu ish atëherë "Vuk Karadžić" tash "Elena Gjika". Deri në klasën e pestë, gjysëm vjetorin e dytë, u ndërta shkolla "Gjergj Fishta" m'duket apo thirret qishtu ajo te Taukbahçja, "Gjergj Fishta" apo?

Aurela Kadriu: Po.

Jakup Qeshmexhiu: E shkum aty. Tetë vjeçaren aty e kom krye. Qe besa, jo tetë vjeçaren po...

Aurela Kadriu: Gjysmën e tetë vjeçares.

Jakup Qeshmexhiu: E kom krye... aty kom shku në të pestën klasë gjysëm vjetori i dytë, t'gjashtën, t'shtatën. E në të shtatën m'ka ngelë profesori i matematikës edhe në të tetën m'ka thanë, "Rri kot se nuk ki me mujtë me kalu ti prej meje". Ka qenë nifarë profesori i vogël, ma murr inati edhe... tani e kom pasë dajën i ngratë prej Malishevës, aty ku u kanë profesor në shkollë m'thirri edhe shkova i dhashë privatisht atje. Klasën e shtatë e të tetën faktikisht dola bashkë me klasën tem e krytëm tetë vjeçarën. Të mesmën e kom kry ktu, ish shkollën teknike...

Aurela Kadriu: Çfarë shkolle ka qenë "Elena Gjika"?

Jakup Qeshmexhiu: "Elena Gjika" sa i përket kualitetit të nxansave që kanë dalë. Prej që e di une gjithmonë kualitetin ma të mirë e ka pasë "Elena Gjika", qikjo "Vuk Karadžići". E ka qenë ni shkollë e vjetër, tani u ndërto qajo pjesa e epërme pak u ndërtue, se filloi popullata me u rritë edhe nuk na nxike. Qashtu sikur tash i kemi pasë ka tri ndrrime edhe qishtu.

Aurela Kadriu: Më interesoj, ma herët e përmendet Çarshinë edhe bonët qat' krahasimin në mes Çarshisë së Shkupit edhe Sarajevës. Po më intereson, a e mbani në mend? A keni kujtesë fotografike qysh u dok' Çarshia e Prishtinës?

Jakup Qeshmexhiu: E mbaj në mend se aty edhe kom punu, kom fillu zanatin aty.

Aurela Kadriu: Si rrobaqepës a?

Jakup Qeshmexhiu: Si rrobaqepës.

Aurela Kadriu: Te kush? A ka qenë...

Jakup Qeshmexhiu: Ka qenë ni kojshi i joni me familje, me shpi atëherë ai e ka pasë Ustah Fadili u kanë. E te ai e kom fillu zanatin. Aty ka qenën ku është tash qeveria... ajo ka qenë prej Teatrit e knena u kanë posta e madhe. Ndoshta sigurisht e dini ju që bombardimi e shkatërroi ata. Ka qenë rruga prej Teatrit e deri te posta e te posta në krah të djathtë ka qenë krejt ajo Çarshia e vjetër me ato dritaret prej drunit e u mbyllshin me qatma i thojshin ktynehere, ku ta di une, e ka qenë kalldrëm. Zanatli, lloj, lloj, lloj zanate ka pasë. Tash s'ka mbetë asnjë hijë. Me tjegulla u kanë, i thojshim çeremide të magjupit, tona kanë qenë qashtu. Tani kanë pasë strehën. Strehat e lokalit kanë qenë përmi ni metër e gjysë janë kanë streha që i qitshin i ekspozojshin ato prodhimin e vet, secili çka kish me punu, çka kish me bo aty.

Aurela Kadriu: E Ustah Fadili ku e ka pasë punëtorinë?

Jakup Qeshmexhiu: E tash, me të kallxue ku osht' kjo Bashkësia Europiane që është ktu në qat' rrugë ka qenë se në mes neve, lokaleve t'vjetra u ndërto qikjo ndërtesa e ish Enti i Sigurimit Social që ka qenë, tash është Ministria m'duket. Përballë kuvendit...

Aurela Kadriu: A, ku ka qenë Ministria e Punës edhe Mirëqenies Sociale?

Jakup Qeshmexhiu: Qaty bile tash e dijna edhe na se për penzione u lajmërojshim qaty.

Aurela Kadriu: Po, qajo.

Jakup Qeshmexhiu: E qaty në mes. Ajo ka qenë n'atë anë na kemi qenë n'ketë anë në mes ka qenë rruga njona, njona mrapa knena ku është kjo Bashkësia Europiane anën tjetër edhe kjo rrugë ka qenën. Tani ka qenë kjo rruga prej bankës, tash është gjysëm rruge prej bankës e dilke te posta n'atë anë edhe u lidhke te Teatri Kombëtar, atëherë Popullor u thirrke.

Aurela Kadriu: Cilës bankë?

Jakup Qeshmexhiu: Banka ProCredit.

Aurela Kadriu: A qaq e madhe ka qenë Çarshia që deri atje a?

Jakup Qeshmexhiu: Ka qenë Çarshia prej... qeveria ku është, ndërtesa e qeverisë, krejt qikjo ka qenë pjesë e... përmendorja qe besa e... qikjo përmendorja, tre rremshi që është, ktu kanë qenë rrugë me lokale, me zanatli edhe ka qenë rruga e drejtë prej xhamisë edhe muzeut drejt ka qenë kah është kjo përmendorja. Se nuk u kanë knena përrethit. po drejt ka qenë rruga. Rruga ka qenë e drejtë. Aty ka pasë zanatli, qajo rrugë krejt zanatli u kanë.

Aurela Kadriu: E a rrxohen qato lokalet e zanatlive për me u maru trekandëshi a?

Jakup Qeshmexhiu: U rrxun ato lokale, m'u maru trekandëshi. U maru trekandëshi tani u maru edhe ndërtesa e kuvendit edhe u shkatërru...

Aurela Kadriu: Në cilin vit është ndërto ndërtesa e kuvendit? A s'osht'...

Jakup Qeshmexhiu: Në '61-shin m'doket është. M'doket me sa e di une. E u rrxun shumë lokale, u rrxun, u rrxun lokale me u maru edhe posta qe besa, atëherë ka qenë posta kryesore qajo e jona. Tash kanë mbetë do po i kanë renovu e do i kanë rrxu kanë ndërto tjera. Qikjo pjesa Rrugën e UÇK-së që po i thojnë, anën e majtë krejt kanë qenën... se ajo pjesë tani ka dalë mrapa qisaj, ka qenë stadioni i vogël i

hendbollit i... krejt ajo pjesë ka qenë me zanatli. Po, unë po thom, fillun me i rrënu marun lokale të reja. Këto kanë mbetë do ende pa u prishën.

Aurela Kadriu: A e mbani në mend deri ku keni ecë nëpër qytet? Që keni thanë jena në qytet.

Jakup Qeshmexhiu: Prishtinën e mbaj në mend kështu, qit' rrugën e UÇK-së që e kemi, deri në fund osht' pompa e benzinës, qaty ka qenë skeji i Prishtinës. N'atë anë, kjo Abëria, Dragodani, aty s'ka pasë kurgjo veç vneshtë, ara, kurgjo. Kurgjo tjetër. Spitali i vjetër ka qenën tash është Ministria e Shëndetësisë aty. Qajo ka qenë shtëpia e skejshme, n'skej të Prishtinës, jashtë Prishtinës. Se në ndërkohë na e kemi pasë edhe ni pjesë të tokës, ni arë tash ku u maru në Dragodan ndërtesat.

Knena, tu shku prej anës të Podujevës e mbaj në mend pak përtej urës që është te Xhamia e Llapit, në atë anë s'ka pasë kurgjo, kanë qenë varrezat në anën e majtë tani u maru qajo "Majami" ni kafe u thirrke. Knena prej lagjes tonë te përmedorja e kryetarit Rugova, qaty s'ka pasë kurgjo, une kom lujtë si fmi futboll aty veç tani u maru qajo përmendorja e atëhershiti.

Aurela Kadriu: Në cilin vit?

Jakup Qeshmexhiu: E nuk e di.

Aurela Kadriu: S'e mbani në mend.

Jakup Qeshmexhiu: Nuk e mbaj në mend. Knena prej anës të "Tre sheshirave" që thojnë, aty ka qenë ku është Rektorati, te Rektorati ka qenë Kazermë e përpjetë Bregu i Diellit krejt ka qenë deri te policia ku është e lagjes të Muhaxherëve, ajo ka qenë kazermë ushtarake. N'atë anë u kanë krejt ara përpjetë, krejt Bregu i Diellit, ara s'ka pasë as shtëpia as kurgjo hiç. U kanë Lagjja e Muhaxherëve knena e knena kah Fushë Kosova, ku është tash Kurrizi aty ka qenë bahçja ma e mirë e cila është furnizue krejt Kosova me perime t'qisaj bahçe qitu.

Edhe fillun me ndërtu, jo ndërtunen tjerrtoeren, jo Shkollën Bujqësore, jo Shkollën Ekonomike. Fillun qishtu gradualisht tu i... kit' qytet... na e kemi ditë fort mirë që prej sundimit të egër të serbëve nuk kemi prit kurgjo mirë po ata gjithmonë kanë shku në atë pikëpamjen që, se na jemi të varun për bukë edhe tokën neve me na prish. Se ni ndër tokat ma pjellore në ish Jugosllavi mas Vojvodinës ka qenë Kosova. Edhe tani fillun gradualisht për me na i humbë tokën pjellore, tu ndërtu ndërtime tjera edhe nuk e arritën qëllimin çka e arriten kta të ashtuquajturit, kta çlirimtartë e tonë. E bonën tokën krejt beton, tash duhet me u var na prej tjetër kujna për bukë.

Aurela Kadriu: Zotëri Qeshmexhiu, po më intereson qato bahçe që kanë qenë kah Lakrishtja...

Jakup Qeshmexhiu: Po. Për qata thojnë edhe Lakrishte është.

Aurela Kadriu: Po. A ka qenë pronë e shtetit ajo? A janë kanë bahçe që me eksportu perime? Çka kanë qenë?

Jakup Qeshmexhiu: Prona private kanë qenë ato. Prona private. Ka qenë kjo që i thojnë lumi, reka se s'u konë lum ai, Reka Prishtina edhe u kanë edhe kjo Vellushka. E krejt ajo kalojke, po atëherë nuk ka pasë ujërat e zeza m'u derdhë në lumin e Prishtevkës apo të Vellushës. Me qata ujë janë ujit krejt bahçet e Prishtinës. Kanë punu qytetartë, aty kanë pasë bahçet e veta, kanë punu. Po thom, krejt perimet janë çka janë asi... na s'kemi pasë importim atëherë as prej Maqedonie as prej kërkujna, krejt prej qituhit kemi marr.

Aurela Kadriu: A s'janë kanë ato që i kanë marr njerz të me qira prej shtetit për me...

Jakup Qeshmexhiu: Jo, jo. Toka private kanë qenë. Toka private. Po gjysa prej tyne që kanë pasë ato kanë dalë në Turqi. Jo gjysa po ma tepër se gjysa. Qytetartë që i kanë thonë vetit si qytetar kanë dalë në Turqi, kanë ikë prej ktuhit.

Aurela Kadriu: A keni pasë bagëti në shtëpi?

Jakup Qeshmexhiu: Qysh?

Aurela Kadriu: Bagëti a keni pasë?

Jakup Qeshmexhiu: Deri m'ka vdekë nana kemi pasë ni lopë, por nuk e kemi lëshu kurrë. Se na e kemi parkun, oborrin edhe parkun muri jem i ndan. S'e kemi lshu lopën kurrë me asi veç gjithmonë e kemi ble barin e parkut e tonë dimrin lopa e ka pasë barin e sigurtë. Dimër e verë qashtu, deri kur u smu nana. Tani kur i morëm këto gratë, këto gratë s'dojshin me i shti dur të nëpër pleh e nëpër asi edhe vëllau e shiti lopën.

Aurela Kadriu: E qai parku i qytetit, a ka qenë gjithmonë park i qytetit?

Jakup Qeshmexhiu: Jo, vorre kanë qenë. Vorret e Prishtinës kanë qenë aty. Po tani masandej u shndërru në park. Bile me të thonë të drejtën të varrosun ni vlla e kom aty, qaty afër murit të shtëpisë.

Aurela Kadriu: E qysh u shndërru në park ai?

Jakup Qeshmexhiu: U shndërru, shteti e murr edhe i qiti vorret në Dragodan atje ku janë. Tani kta e përpunun, e rrafshun edhe...

Aurela Kadriu: A kanë bo zhvarrosje të njerëzve?

Jakup Qeshmexhiu: Për zhvarrosje nuk e di, po m’duket se jo, veç e kanë mush me dhe e nuk e kanë asi... zhvarrosje jo. Se kur e kom maru une në ‘94-tën, ‘93-tën kur e kom ndërtu shtëpinë teme, m’kanë dalë eshnat e njerzve. Murin kur e kom ndërtu m’kanë dalë eshnat e njerzëve. Edhe sot me shku është ni pjesë qitu pak ma poshtë prej neve u shemb dheu i parkut edhe kanë dalë eshnat krejt. Bile kur erdhën NATO-ja kujtojshin mos janë t’varrosun t’luftës. Thojsha, “Jo, jo këto janë veç me vite përpara”. Se une kom dalë me ta i kom enën nëpër krejt parkun. U tutshin, thojshin, “Mos ka të minune rrugën” thojsha, “Jo, hajdeni me mu se e di që në këtë lagje...” une kom dalë edhe gjatë bombardimit nëpër qytet, nuk jom mbyllun.

Aurela Kadriu: Sa vjet keni qenë në qirak te...

Jakup Qeshmexhiu: Po kqyre, qirak kom qenën dy vjet e gjysë te qiky kojshia jem. Tani, mas dy vjet e gjyse kalove te ni mjeshtër tjetër si punëtor. Tani kom shku deri në vitin 1974 si punëtor kom punu. ‘74-tën u punësova në Llotari të Kosovës.

Aurela Kadriu: Çka bojke Llotaria e Kosovës në atë kohë?

Jakup Qeshmexhiu: Llotaria e Kosovës ka qenë prodhuesi ma i mirë i pareve, sikur qysh e ka majtë Jugosllavinë Trepça, qashtu Kosovën e ka majtë Llotaria. Po, fatkeqësisht erdhën do njerëz e shkatërrun edhe...

Aurela Kadriu: Çka keni punu në Llotari?

Jakup Qeshmexhiu: Përfaqësues i Llotarisë kom qenë.

Aurela Kadriu: E ku ka qenë zyrja e Llotarisë?

Jakup Qeshmexhiu: Zyret kanë qenë përballë Rektoratit. Tre-katër vena. Ma së pari e kanë pasë te Lagjja e Muhaxherëve, tani kalun përballë Rektoratit, prej atyhit tani shkun në Kurriz atje.

Aurela Kadriu: Qysh ka qenë qajo pjesë që e keni pasë zyren qaty?

Jakup Qeshmexhiu: Qysh?

Aurela Kadriu: Ju keni qenë...

Jakup Qeshmexhiu: A jo... unë kom punu në kioskë. Përfaqësues kom punue në kioskë. Ma së pari e kom pasë kioskën te... përballë postës t’vjetër që është bombardu. P’i atyhit tani masi u bombardu posta dola knena përballë bankës, Procredit Bankës që është përfundi komunës. E prej atyhit erdh

njani i mshoi me kerr e prishi. Tani dola ktu ku ka qenë, kjo Xhamia e Çarshisë që është tash, aty katër kioska kemi qenë. Deri në largim qaty kom qenë.

Aurela Kadriu: E kur u hekën kioskat krejt?

Jakup Qeshmexhiu: Kush kioskat a?

Aurela Kadriu: Po.

Jakup Qeshmexhiu: Kioskat, po mendon të llotarive?

Aurela Kadriu: Po krejt në përgjithësi, po edhe të llotarive.

Jakup Qeshmexhiu: Në përgjithësi janë hekë mas luftës, mas luftës. Unë nuk e di çfarë shteti është ky kur ni shtet ni kioskë mos me pasën... tash i kanë qit' do farë kioska. S'e di, atëherë u dalë kioska për shtypin me shitën, cigare me shitën, do qisi farë... tash po shitshin edhe pije edhe he, se di. S'po dihet a është lokal, a kioskë.

Aurela Kadriu: Qysh kanë qenë qato vjet si punëtor në kisokë?

Jakup Qeshmexhiu: Qysh kanë qenë qato vjet si punëtor në kisokë? Qysh i mbani në mend?

Aurela Kadriu: Unë... si ma të mirat. Për karrierën tem ma të mirat i kom pasë qato. E kom pasë nifarë respekti, nifarë... prej qytetarëve të Prishtinës. Po le respekt prej qytetarëve, po në emën tem kanë shku në Kuvend Komunal, atëherë ka qenë Kuvend Krahinor, në Komitet Krahinor. Në emën tem njerëzit kanë shku kanë kry punë. Sepse kom pasë kontakte shumë, me palë të shumta. Se lujshin njerëzit, lujshin lloton e prognozës sportive, llotarinë e lujshin edhe tani une çka kisha mundësi iu tregojsha, i msojsha i asisha... edhe kom pasë nifarë... po të njejtën famë e kom fitu tash edhe me qit' zanat. Po tash e kom fitu me zanat se jom për hastret në Prishtinë. I vetmi jom une në Prishtinë që i riparoj çantat. Kërkush në Prishtinë nuk riparon çanta. E ti sa dush munesh me u idhnu e me thanë, "Hajt mjeshtër e çoj tjetër kund", s'ki qare apet pa ardhë te une (qeshë).

Aurela Kadriu: E mandej kur...

Jakup Qeshmexhiu: U largova prej llotarisë. U largova prej disa njerëzve të cilëve nuk s'iu bisha... s'iu nënshtrijsha edhe m'largun. M'thirri Enver Petrovci, m'thirri për me i punue niparë, njo pesë palë kostume për një shfaqje të Teki Dervishit të ndjerit, "Kufiri me atdhe". Edhe shkova u mora vesh me to. Po m'pyt Enveri, "Jakup a don me punu?" Thashë, "Për çka profesor?" Tha, "Si kosumograf" thashë, "Po". Thashë, "Jom mbetë pa punë..." Jo qe besa, prej atuhit e pata lokalin, ish kafja e vjetër e penzionerëve...

Aurela Kadriu: Ku ka qenë kjo?

Jakup Qeshmexhiu: Përballë në anë të poshtme të Bashkësisë Europiane, aty paguhet edhe rryma. Se di a e din atë farë rrugën, qatë ka qenë. Aty e kom pasë lokalin. Po ni...

Aurela Kadriu: Lokal t'jujin e çelët?

Jakup Qeshmexhiu: Jo, e kom pasën prej kësaj, Lidhjes së Penzionerëve të Prishtinës. Tani erdhën masat dhunshme viti 1992 edhe m'largun mu me ni shqip-folës, po ia thom edhe emrin se ma ka plas zemrën, ky, qe qysh e harrova emrin. Mustaf Rezniqui. Ai u bo me shkije hini në masa të dhunshme. Mu m'largoi me gjithë... dy familje prej qatij lokalit kemi jetue. Ja u dha djemve t'vet. Tani m'thirri mu Enver Petrovci, shkova i punova qato kostume edhe fillova me punu...

Aurela Kadriu: Në '92-tën shkut në Dodonë a?

Jakup Qeshmexhiu: Po në Dodonë. Prej '92-tës deri '97-tën në Dodonë jom kanë.

Aurela Kadriu: E kom ni pyetje se pak u ngatërrova. '74-ten nuk punoni ma për Llotarinë e Kosovës?

Jakup Qeshmexhiu: Jo, s'kom punu prej '85-tës. Prej '85-tës në llotari s'kom punue e në '74-tën kom hie. Prej '85-tës tani jom... e kom pasë lokalin tem '88-'89 e çela. Punova katër vite edhe aty tani na largun qita, masat e dhunshme të serbëve tani shkova në Dodonë '92-tën. Në '92-tën kom punu deri '97-tën. Kur erdhën masat e dhunshme u largue Enver Petrovci, u largue Teki Dervishi, u largue edhe ni femër e Gjakovës nuk e di edhe une.

Aurela Kadriu: E çka bojke Dodona në qat' kohë? Ka qenë i vetmi institucion që...

Jakup Qeshmexhiu: I vetmi institucion, i vetmi institucion që ka ekzistue nën sundimin tonë shqiptarë ka qenë qajo. Po fatkeqësisht i kemi pasë do njerëz edhe kemi sot e kësaj dite ma tepër tash, të cilët iu ka thanë, i ndjeri Faruk Begolli, "Ua liroj une institucionin me mbajtë mledhje komerative, me majtë lloj lloj mledhje po mos tregoni ku, mos tregoni ku". Fatkeqësisht ni koleg i juvi, gazetar, p'i thom koleg i juvi se nuk e di kush ka qenë. E tregoj mledhjen që u majt tha, "Në Teatrin Dodona u mbajtë filon mledhja". Vishin krejt njerzhtë, çka ishin ma... Edita Tahiri ma tepër ka nejt aty. Edhe të nesrit veç kur janë gju masat e dhunshme. Edhe po i thom Enverit, "Profesor, merr bre masa diçka" tha, "Jo, Jakup se nuk i nënshtrova kërkujna. Qitash..." tha, "p'e çeli telefonin po e thirri Beogradin. Nëse guxojnë me nejt qita qitë unë me kokë lidhna. Po nuk i bi..." tha, "n'dy gujt kërkujna. Ktyne sidomos" tha, "ktyne jo". Edhe kemi dalë. Tani aty masi u largova prej teatrit... se kom punu edhe kostumograf edhe garderober...

Aurela Kadriu: A rrijmë edhe pak te teatri?

Jakup Qeshmexhiu: A?

Aurela Kadriu: A rrijmë edhe pak te teatri?

Jakup Qeshmexhiu: Fol.

Aurela Kadriu: Ndoshta, me siguri e mbani në mend, të paktën disa shfaqje të cilave ua keni bo kostumet.

Jakup Qeshmexhiu: Kostumet i kemi bo, “Ditë Vere” e Melihate Qenës, “Kufiri me Atdhe” të ktina Teki Dervishit, nuk e di qysh u thirrke edhe ajo ka qenë... lujshin kta aktortë Veton Osmani edhe Sunaj Raça. Lujshin ni shqiptar kosovar edhe ni shqiptar i Shqipërisë. Po qe kom harru edhe emrin qysh u thirrke. Bile kom punu edhe me ni kolege t’juj Samka Ferrin. S’e di a e njifni? Me to e kom pasë nifarë problemi t’vogël. Masi... m’thirri për qita “Kufiri me atdhe” ai ma dha fotografinë çfarë kostime duhet me bo.

Ndërkohë u rrok me Enverin diçka asi edhe m’thirri mu prej shpije në telefon. Tha, “Jakup merri fotografitë e hajde”. Kur shkova “Ami” tha, “fotografitë” tha, “Merru vesh ti me Enverin çka t’dush”, “O Samka, kadal bre çka u bo?” Tha, “Kurgjo”. Shkova thashë, “Profesor...” tha, “Hiq sajna bre, ajo është e cokat” tha, “osht”. Tani e veta, thashë... Teki Dervishin, thashë, “Profesor tregom me çka ka t’boj me kit’ shfaqje” tha, “Ustah Jakup...” tha, “ka t’boj kshtu, pesë të burgosun m’i maru do si dane [pixhame] me lidhse ktu {tregon me duar}, dy gardieneve me iu maru komplete fun, kostim edhe kapelen. Qito...” tha, “ka t’boj, kurgjo tjetër”.

Thashë, “Unë i kepi teshat veç e pyti myshterinë e lehmo kto”. E ia bona. Tani m’ka pasë nxjerrë pak problem, pse me u shkru aty kostumografi Jakup Qeshmexhiu po duhet me u shkru Samka Ferri. “Po Samka...” thashë, “ti i tërhjeke ato. Qysh me të shkru kur ti u tërhjeke prej sajna?” Thashë, “Edhe une nuk jom me i reklamu me reklamën ‘Kufiri me Atdhe’”. Mu m’kanë ardhë edhe prej Beogradit kanë kep tesha te une kur e kom pasë qitu te kafja e vjetër e penzionerave rrobaqepësinë.

E tani masanej e murrën masat e dhunshme. Faruku i ndjerë edhe nën masa të dhunshme e ka pagu me qira Teatrin Dodona. Ka investu pare t’veta prej xhepit, personale. Që u konë pagu ni film mas luftës, në Ljub... Slloveni që u bo 80 mijë mark i ka marrë, 40 mijë mark i ka investu Faruk Begolli në teatër. Edhe po e pytim, “Pse?” Tha, “Sikur të na mbyllet qiky teatër shuhet Fakulteti i Arteve, Dega e Aktrimit e me gjysë shpirti e kom arrit me e hapën e tash me m’u shu”. Edhe mbijetoi, e mbijetoi deri në çlirim e mbijetoi.

Ka pasë shfaqje të mira, komedi ma së tepërmi se atëherë s'kishin, popullatës nuk kishin kurfarë institucioni e në Teatrin Dodona komedi veç sa për me u aktru [argëtu] pak, me u hjekë ata mllefi. Kemi pasë shumë... ka qenë shfaqja e cila e ka thy rekordin "Profesor, jom talent se jo mahi". Ajo ka thy rekordin e t'gjithave, nuk ka me mujtë me arritë kërkush qata.

Aurela Kadriu: A udhëtojshin aktortë?

Jakup Qeshmexhiu: Udhëtojshin. Kemi pasë prej Mitrovice, kemi pasë prej Suhareke, kemi pasë prej Gilanit, kemi pasë të gjitha anëve. Se unë... gjenerata e parë e Farukut, unë kom qenë aty, ndër ta është Veton Osmani sigurisht është edhe bashkëpunëtor i juj aty në televizion. Sunaj Raqaj është, ai është gjeneratë e artë e aktorëve tonë. Masandej, tani fillun vishin prej tona anve.

Pjesa e Dytë

Aurela Kadriu: E juve a iu bijke me shku nëpër vende si kostumograf?

Jakup Qeshmexhiu: Jo, nuk shkojsha, se ma së tepërmi, vetëm qikjo shfaqja "Profesor, jom talent se jo mahi" kjo u asi... edhe e kukullave. E kukullave çka kish nevojë unë i kepsa ose të ktyne aktorëve i kepsa në shtëpi se s'kisha çka me shku atje. S'kishin vend se e kemi pasë vetëm ni kombi e me qata tani për qat' arsye nuk shkojsha une fort. Qe besa tani masandej i angazhova, dy djemtë i angazhova se dojsha me u tërhjekën vet.

Aurela Kadriu: Si çka djemtë?

Jakup Qeshmexhiu: Djemtë njani si kostumograf, tjetri e majke byfenë e teatrit.

Aurela Kadriu: A punojnë djemtë me juve?

Jakup Qeshmexhiu: Këtu?

Aurela Kadriu: Po.

Jakup Qeshmexhiu: Jo. Momentalisht krejt jashtë i kom. Pos' ni vajzë e kom tash me këtë grunë e dytë ktu, se katër fmi me grunë e parë krejt i kom jashtë. Njo e kom në Itali, vajzën e kom në Gjermani, djalin e dytë e kom në Zvicërr, djalin e vogël e kom në Londër.

Aurela Kadriu: E tash punoni vet, apo?

Jakup Qeshmexhiu: Veç vet jom. Djali i dytë e punon rrobaqepësinë, çanta-punues jo, a rrobaqepësinë po e punon. Po e la gjysë, se masi shkoi në perëndim atëherë e la gjysë. Vet qitu punoj. Sa t'më jep Zoti shnetë nuk dorëzohna, kur ma ndërpret ai atëherë edhe unë duhet me ndërpre.

Aurela Kadriu: E qe sa vjet jeni në këtë lokacion?

Jakup Qeshmexhiu: Në qit' lokal si çanta punues punoj qe katër vite, jo valla katra e gjysë se. Dy vite e gjysë kom punu përballë Shkollës "Elena Gjika" aty. E 15 vite kom punue me qat' firmën e çantave. Mas teatrit, kur u largova prej teatrit fillova çanta. 15 vite te ai si shef i prodhimit edhe si modelar i çantave.

Aurela Kadriu: Çfarë fabrike ka qenë kjo?

Jakup Qeshmexhiu: Fabrika e çantave "Eni" u thirrke.

Aurela Kadriu: Ka qenë private a?

Jakup Qeshmexhiu: Private ka qenë.

Aurela Kadriu: A ka qenë në Prishtinë?

Jakup Qeshmexhiu: Në Prishtinë ka qenë. Ma së pari e kemi pasë në Breg të Diellit, prej atuhit kalum në tjegullore kha, prej tjegullores kalum te... afër Teatrit Dodona qaty...

Aurela Kadriu: Qysh kanë qenë ato vjet?

Jakup Qeshmexhiu: Urdhno?

Aurela Kadriu: Qysh kanë qenë ato vjet?

Jakup Qeshmexhiu: Të mira kanë qenë, po për mu jo bash të mira se isha si shef i prodhimit e... pare bile po bisedoj me kto, kurrë shefin s'e dojnë punëtortë as drejtorin jo (qeshë). Edhe mu diqysh më urrejshin pak se kisha qef me qenë strikt në punë, kisha qef me e pasë ni edukatë në punë. Se s'i mos t'ka njeriu ni edukatë si në punë, si në nej, si në bisedë, si në he, si në çdo gja mos prit prej tyne kurgjo. E kisha qef me e pasë ni edukatë në punë edhe e kom majtë. Bile kur e kom lshu këtë firmën i kom thanë atij padronit tem, "Qëllimin tem e kom arritën. Puna del e pastërt shumë. N'dish me majt, maje. Mos dish, une ma s'jom ktu". E tani edhe ai e vazhdoi deri qitash, njo gjashtë shtatë vite, qitash e ka mbyll edhe ai.

Aurela Kadriu: A m'tregon për shkollën e mesme?

Jakup Qeshmexhiu: Po.

Aurela Kadriu: Ku ka qenë ma së pari objekti?

Jakup Qeshmexhiu: Shkollën tem të mesme që e kom krye ma së pari, tash “Ahmet Gashi” po i thojnë, atëherë u kanë Shkolla Teknike “29 Nëntori”. E qaty e kom pasë une shkollën e mesme. Bile këtë ndërtesën e vjetër ktu.

Aurela Kadriu: Po, tash ku është arkivi.

Jakup Qeshmexhiu: Arkivi? Po, po, arkivi është. Tash është Arkivi Komunal. E qaty e kom pasë shkollën e mesme. Kom qenë gjenerata e fundit, 1967-tën si nxonës i nxanësve në ekonomi për zanate e asi... gjenerata e fundit kemi qenë na.

Aurela Kadriu: Çka kujtoni? A keni ndonjë kujtesë prej shkollës t’mesme?

Jakup Qeshmexhiu: Kujtesa sa të dush kena. Atëherë kemi fol... gjysën e ma tepër t’landëve i kom pasë serbisht, se po thom ‘65, ‘66, ‘67. Atëherë ka qenë shkolla e mesme serbisht, na e kemi pasë. Për me krye praktikën... praktikën e kemi kry ni muj ditë në Suboticë. Edhe atëherë kemi pasë probleme gjithmonë siç e kemi pasë zanat. U rrehëm në Suboticë me shkije e nja pesë vetve na largun neve.

Aurela Kadriu: Prej shkollës a?

Jakup Qeshmexhiu: Prej kursit, prej praktikës që e patëm. Po fatbardhësisht u bonëm tub bashkë e thojshim ose keni me na kthy krejtve ose... deri m’ka thirrë mu drejtori, se une e disha gjuhën serbe. M’ka thirrë mu edhe më premtoi edhe u betu në fmi tha që, “Si t’vish në gusht, veç keni me hi e me dalë s’ka me iu pytë kërkush, veç kthenu”. Se i bonëm njo katër shkije për spital edhe... pesë qe besa. Dhe tani erdhëm na. Kur erdhëm këtu na dul problem me sekretarin e shkollës, u kanë nifarë Elmi Muçolli, s’dojke me na pranu. E ni kohë, nja dy muj ditë e kemi shty qashtu t’u shku e me menxi na pranoi diqysh. Na edhe e kryjtëm aty, po thom gjenerata e fundit kemi qenë na.

Aurela Kadriu: A keni dalë si t’ri në çarshi?

Jakup Qeshmexhiu: Qysh?

Aurela Kadriu: Si të ri a keni dalë në çarshi?

Jakup Qeshmexhiu: Po, po rregullisht. Rregullisht kemi dalë në çarshi. Kemi dalë po kemi pasë pak edukatë. Une p’e shoh qitu se krejt shkolla, gjimnazi “Sami Frashëri” osht’ tash është kohë pushimesh. Ju me ardhë kah ora 9:30 këtu, as gjilpanën s’ki ku e lshon prej nxansave. Po i kanë sjelljet shumë jo të

mira, a mu s'po më pëlqejnë. Jo s'po më pëlqejnë, po s'jonë, nuk janë... A na kemi pasë pak edukatë. As nuk kemi bërtitë palidhje, me u sha, me asi jo. Kemi qenë shumë, shumë të... kemi ditë se jemi frigu edhe prej arsimitarit, prej mësuesit.

Mu vet ka ardhë mësuesja e “Elena Gjickës” m'ka thanë, “Mjeshtër, mall p'e kom me dalë me bashkëshortin tem n'rrugë t'u m'thirrë fmija me emër e tu u mshef”. A na kemi ikë kur e kemi pa msusin, kemi ikë mos t'na sheh. Se ka thanë, “Pse je dalë e s'ke nejt me i bo detyrat, a me mësu?” Ku ta di unë. Po kemi pasë ni edukatë, po them, e kemi pasë ni respekt ndaj mësuesit. Sot s'ka respekt ndaj mësuesit. Unë i kom thanë edhe kujdestarit t'vajzës, “Rrehe, une po ta jep lejen. Rrehe, tani thirrëm në telefon e une i jepi diçka tjetër kur t'më vjen”. Qatëherë, qishtu u majtë edukata në shkollë.

E sot del i thotë arsimitarit e mësuesit e shan e i mshon. Ajo është diqysh jashtë çdo rregulle bre. Na s'e kemi pasë këtë traditë. Prej stërgjyshërve tanë, qikjo traditë s'ka qenë e tash e kanë bo. E kush i ka fajet? Prindërit i kanë fajet. Shkollën në gjimnaz e kom pasë djalin e dytë, 38 nxanës i ka pasë arsimitarja. Arsimitarja, motra e ktina advokatit, Rukiqit. Ajo ka qenë ni arsimitare shumë e urtë. E ka pasë ni nxanës në 38 që e rrotullojke krejt klasën. Prindi i tij thojke, “S'du me ma ngucë fminë”.

E patëm tani ni polemikë me to. P'i thom, “O zotëri, nëse ti s'don me ta ngucë fminë, paguje arsimitarin n'shpi maje privat edhe une s'lejoj me ia prish qetësinë djali fmive tonë në shkollë”. Kemi pasë, po thom, prej prindërve jemi tutën edhe prej arsimitarëve jemi tutën. Po jo që na kanë rre, se arsimitari si prindi i dytë. E tash jo, tash...

Aurela Kadriu: Ku dilshi në çarshi?

Jakup Qeshmexhiu: E kemi pasë... teatri ku u kanë, qaty u kanë çarshia. Nuk ka qenë as shtëpia e mallnave nuk ka qenë aty. Aty kanë qenë lokale kah shtëpia e mallnave. Shtëpia e mallnave tash është Administrata Tatimore, kjo ndërtesa e qeverisë e. Lokale kanë qenë. U kanë poshtë ku është tash Kino ABC, kjo te Qafa, shkojshim. Ka qenë ABC kjo aty përballë Komitetit Krahinor ka qenë, i thojshin, Vllaznimi, Kino Vllaznimi. Shkojshim në kino kqyrshim kino. E kemi pasë prej treve fillojke Kino Vllaznimi, prej katërve fillojke Kino Rinia, shkojshim.

Aurela Kadriu: A shkojshi tek te dyjat, a keni shku për shembull kur jeni konë ma...

Jakup Qeshmexhiu: Po kur kanë qenë filmat e mirë i kemi përcjellë edhe në Kino Vllaznim edhe në Kino Rini. P'e nxojmë prej orës 3:00 shkojsha deri në 5:00 aty, prej 6:00 deri në 8:00 e kqyrsha në Kino Rini. Se s'kemi pasë asi që janë tash këto për kta t'ritë, jo Boro e Ramizi që u bo salla e ku ta di une. Jo, jo, ato s'i kemi pasë.

Aurela Kadriu: E çfarë filma vishin nëpër kinema? A keni kujtime kështu që mbani mend prej kinemave?

Jakup Qeshmexhiu: E kujtimet ma të mira i kom pasë, po të gabushme i kisha pasë. Nashtë s’kem çka me bo. Në 1974, ajo ka qenë java e filmit shqipëtar, po kënaqësinë që e kemi pasë, çfarë kallablaku u bojke... s’ka pasë orar që ka fillu filmi që su kanë me spicë [plot] t’mbushun. Qaty kanë qenë filmat e mirë. Tani kemi pasë, ktyneherë ma së shumti i kqyrshim filmat *western*. Ah, qatëherë ish kanë... qat’ javën e filmit që e kemi pasë atëherë ‘74, qatëherë veç edhe filloi me marrë frymë këtu në Kosovë. Kemi pasën koncertin në Stadium të Prishtinës me kangtarë të... edhe atë e mbaj në mend se kam qenë 20 vjeç m’doket, me kangtarë të Shqipnisë. Kanë qenë Fitnete Rexha, ky... qe i kom harru emrat.

Aurela Kadriu: Në cilin vit osht’?

Jakup Qeshmexhiu: ‘70-tën m’doket. Stadium u mushke...

Aurela Kadriu: Për çka u mbajke ai koncert?

Jakup Qeshmexhiu: Koncert i kangtarëve të Shqipërisë. E sa njeri e ka djegë kmishën, setrën, çadrat ma, veç dilke çadra e dhezne kshtu e majke. Po, kishmi pasë gabue.

Aurela Kadriu: Pse?

Jakup Qeshmexhiu: Pse? Pse na tu i dashtë e tu i favorizu ata, ata tu na injoru neve. Edhe sot e kësaj dite injorohemi prej tyne. Me marrë me bo ni, qysh me thanë, ni anketë 30 përqind e atyne s’na dojnë neve, a m’i vet kta tontë 70 përqind kanë qef për me u bashkue. E po thom, e kemi pasë koncertin, ni ndër koncertet ma të mira në jetën teme, atëherë jom knaqën. Deri në ora 10:00 në mramje, që kurrë 10:00-tshi s’na nxike neve. Deri në ora 10:00 a 10:30 e majtën edhe vazhdoj ajo se se ka pasë në 8:00 me u kry po u vazhdue. U kanë ni knaqësi që s’mahet mend ajo kënaqësi.

Aurela Kadriu: A e dini kush e ka organizu?

Jakup Qeshmexhiu: Jo, jo. U organizu se pak u hapën rrugtë, tani fillun me marrë thu shkijet, se s’po muj me iu thonë serbët po shkijet. Murrën n’thu pak shkijet, na u liru neve frymëmarrja. E qatëherë fillun tani erdhën edhe java e filmit shqiptarë, erdhën shumë sene, vishin qe besa edhe do profesora nëpër fakulteta.

Aurela Kadriu: E ku ke qenë gjatë luftës?

Jakup Qeshmexhiu: Prej ditës t’parë në shtëpi kom qenë, s’kom dalë hiç, në shtëpi te parku naltë.

Aurela Kadriu: E pse vendosët me nejtë në shtëpi?

Jakup Qeshmexhiu: Kom dashtë me u bo patriot, po ish kanë gabim.

Aurela Kadriu: Qysh ka qenë Prishtina në qat' kohë?

Jakup Qeshmexhiu: Në atë kohë ka qenë tmerr, tmerr. Dilsha në qytet... jo që... as që jom kanë trim, jo as që jom kanë i meçëm, jo po s'e kish pasë shkru Zoti me dalë me pi ujë tjetër kun, pos në shtëpi temen. Presion s'kom pasën. Nuk kom pasë presion, s'muj me thanë. Kanë ardhën se në ç do lagje dilshin në javtë e kontrollojshin. Kur erdhën te shpija, kur erdhën më kontrollun. Te vllaznia... se njanin vlla, t'madhin, ma qitën vet të 17-tin mbetëm na tre vllaznia. 52 anëtarë i kom pasën kur kanë hi me i largu prej shpije. Edhe fatbardhësisht neve s'na prekën, po në ndërkohë ata miqtë e nipit tem, "Dajë po dalum, dajë po dalum", "Hajt dilni". Tani ata dulën, na i mshelëm dyrtë edhe ma kurrë s'kemi pasë kurfarë presioni... janë ardhë...

[Video-Intervista ndërprehet]

Aurela Kadriu: Mbetëm te lufta.

Jakup Qeshmexhiu: Na erdhën te shpija... kalojshin rrugës policia edhe po m'pysin, "A i keni nxjerrë kartonat e gjelbërt?" Na jepshin do kartona t'gjelbërt me e ditë sa anëtarë jena, me ditë a ka njerëz të shpërngulu, a ka njerëz të shpërngulun prej fshatit ktu, edhe po m'thotë mu... "Jo s'i kom marrë", "Pse?" "Se s'pres, kallabllak". Në fund të parkut u kanë ajo ndërtesa, ni hotel i ni sërbit, e aty shkojshin i merrshin. Tha, "Hiç mos shko. Nesër shkoj e t'i bi. I plotëson sa i ki në lagje, i regjistron tani i vulosi e me ta ti dil tani në qytet".

Na i prunën ato. Unë i shënova qe besa i patëm vendosë nja pesë familje që i kanë pasë shpërngulë prej Llapit e shkun në kufi. Në kufi i kanë kthy, tani erdhën aty e metën e i vendosëm nëpër shtëpia që ishin dalën. E tani qatyne ia nxjerrëm ato letrat, kartonat e gjelbërt. Edhe nuk na ka pengu kërkush hiç. Tani mas anena dikush... se lagjja jonë, muj me thanë që veç 20 përqind kanë dalë në qat' kohë që e patën atë farë *oluje* [Srb. shtrëngatë] shkijet që e bonën. Masandej kanë dalë prej vetëvetiu, prej tute, prej tute. E na s'kemi dalën.

Dilsha në qytet, çka ki me dalë, katastrofë. Sikurse sërëbët tash kur t'dalin, a i ke pa, s'nihet zani se s'ka, kërkush s'flet sërëbisht. Atëherë kërkush s'folke shqip, po krejt sërëbisht. E ka qenë ni tmerr i madh, po jo me t'ngucë dikush nuk të ka ngucë kërkush. E dy here, se vajzën e kom pasë të vogël, e m'ka lypë vo të zine. Jom dalë këtu tash ku është Hotel Unioni, aty janë kanë do lokale. U kanë ni lokal i Fushë Kosovës, shitke mish e vo e sene. E tani shkoja, bleva. Kur kom ardhë qitu te Shkolla "Elena Gjika", prej ktuhit e deri te Xhamia e Çarshisë kanë qenë cik-cak ushtria, paramilitarë, tybe ta di çka.

M'u kthy s'guxojsha, me u kthy thojsha se dyshojnë diçka edhe m'gjujnë. Edhe kom fillu kom hi ktu ku osht' Ministria e Diasporës që ka qenë Gjykata Komunale. Po, po, Gjykata Komuale ku u kanë, n'atë

anë muzeut. Aty ka qenë Gjygi Ushtarak, e për qata prej ktuhit deri atje ka qenën krejt ushtarë. Çdo pesë metra qeshtu i ke pasë deri te xhamia ku po renovohet atje. Shkova bleva, u ktheva prapë knena s'më nguci kërkush. E magjuptë atëherë kanë dominue. Në atë kohë kanë dominue magjuptë. Te tregu i Prishtinës u bojke, qaty u kanë ajo na i thojshim domi i mahallës.

Krejt tregu u bojke qatje naltë. Çka ki dashtë ki ble në rrugë atje. Ndash shiqer, ndash langje, ndash kryp, biber, e t'gjitha çka janë shitë, se shkijet i zbrazshin këto shitoret e shqiptarëve edhe i merrshin romtë me punue si punëtor, pare s'ju jepshin, u jepshin mall. Tani ata i shitshin, me cigare, me krejt. Krejt Prishtina qaty kanë ardhën kanë ble. E po thom, tani kur filloi... që fillunë shkijet me u tërhjekën atëherë fillun edhe... qe besa i pari magjup që u hjekë prej atuhit u hjekë shkaku jem. Se m'ka pasë thanë mu kur dola aty tha, serbisht tha, nuk p'e citoj sërabisht p'e thom shqip, "Nuk kam me fol këtu shqip, po serbisht".

Edhe i kom pasë tregu i kom thanë, "Ni ditë, n'ardhtë dita jeme dije që pa ta hjekë flamën s'e lo". Edhe masi shkun krejt që hinen rusët ktu, une dola në treg me i ble do sene. P'e takoj tha, "Kojshi, a mujte?" Thashë, "S'ka me folë ktu shqip veç serbisht ka me u fol" thashë, "e qitash masi jom nrxanën pshtove mirë". U shku i ka thanë babës t'vet, "Une ika valla se djali i Ramadan Qeshmexhisë e ka bo njet me m'mytë". Edhe i kanë marrë torbat e kanë ikë. Prej atina tani kanë fillu njo mas njo qishtu.

Aurela Kadriu: A e kishit njet përnime me mytë a?

Jakup Qeshmexhiu: A?

Aurela Kadriu: A e kishit njet përnime me mytë?

Jakup Qeshmexhiu: Kqyre çka po ju tregoj, në atë kohë ke mujtë me mbytë njeriun sikur zogun me mytën, kërkush s'u interesojke. Për me mytë s'kisha mujtë me mytë, se na e kem pak shpirtin e... me mytë jo, veç për pa e rreh me shtre për toke s'e kisha lonë. A din kështu me shtre për toke që menxi ish çu në kamë të veta. Por fatbardhësisht iku, shkoi. Tani ma s'di çka u bo ma tutje.

Aurela Kadriu: Dashta me iu pytë...

Jakup Qeshmexhiu: Fol.

Aurela Kadriu: Ma herët për qat' kohën e luftës e ket' tu folë, që m'kallxun që keni mujtë lirshëm me mytë...

Jakup Qeshmexhiu: Po, po.

Aurela Kadriu: Po më intereson qysh e rigjetët vetën në lagjën e juv mas luftës?

Jakup Qeshmexhiu: Në lagjën tonë, gjithmonë, lagjën tonë kemi qenën, e kemi pasën do njerëz, e kom pasë ni vlla goxha problem u kanë, problematik, e iu tutshin krejt magjuptë, po nuk ka bo probleme. Gjatë bombardimeve edhe unë e kom pasë ni problem se ni plak ka pasë mbetën në shtëpi, krejt familja i ka pasë dalën, ai 85 vjeçar ka pasë mbetë në shtëpi. Tani ni magjup, ni djalë magjup, baba i punojke në Sekretariat të Punëve të Brendshme edhe nana qashtu edhe e kish pasë nisën me i ra atij plakut.

Ai po m'tregon mu, se unë atë plakun e kom majtë, gjatë bombardimit unë e kom majtë, se ai vetëm s'kish asi... tani e kom majtë në shtëpi. Qe besa veç gjumin e bojke në shtëpi t'vet, se ushqimin, me u la, me u pastru krejt te une i ka bo. Edhe e nxuna ato, e kish pasë ni nifarë tranzistori i thom, "Paja qikah". E kapi, kap t'ja ngjes për fyti e t'ja dalldisi nja tri-katër shuplakë t'mira edhe shkon i kallxon nanës t'vet. Atje kur t'vijne, kta magjupët qysh e kanë pasë zanat, njo me rre 500 u bojshin me ta.

Kur vijne te shpija, une kom dalë në qytet, e kishin pasë bo telashe vëllaun. E kur t'çohna une t'shkoj në shtëpi të tyne. Thom, "Qy çka po t'kallxoj, me bo me ardhë ni milic me m'cokat te dera ka me iu kallë krejtve. Ka me iu kallë krejtve". Edhe nuk lujti kërkush. Thashë, "Edhe atë plakun me bo me ma ngucë edhe niherë dije që iu myti krejt". Ke mujtën, po thom, ke mujtë me mytë njeri sikur në... ni zog me mytën, qashtu. Se s'i interesojke kërkujna, ishin shkijet ma të knaqun nëse e kishe mytë njo.

Aurela Kadriu: Zotëri Qeshmexhiu, a e mbani në mend Bozhurin?

Jakup Qeshmexhiu: E mbaj në mend Bozhurin (qeshë). Vitin '68, atëherë unë isha si punëtor edhe me siguri ka qenë një ndër hotelet ma të mira në Kosovë, se jo në Prishtinë. Se ai ka qenë i vetmi në Prishtinë. Edhe shkum me do shokë me pi kafe... edhe jom pak si hajgarexhi, kom qef me bo hajgare. "Mos më çoni atje se e thej krytë prej pasqyre s'di kah shkoj" se pasqyre n'tona antë ka qenë.

E kur hinëm mrena, porositëm kafet edhe çka bona une për me bo pak ni komedi aty thashë, po ia boj njanit i ndjeri Sali, thom, "A qishtu pihet kafja?" E kom kap filxhanin qishtu {tregon me duar} edhe p'e pie. Ai qysh e ka pasë kafën n'gojë e krejt e ka bo çarçafin e bardhë (qeshë). E Bozhuri ka qenë, po thom, një ndër hotelet ma asi... nuk kam qenë adhures i kafeve t'mdhaja, po kemi hi. Kur kemi pasë kemi hi kanihere qishtu.

Aurela Kadriu: A keni naj qisi storie si qikjo për Bozhurin tash për Unionin?

Jakup Qeshmexhiu: Qysh?

Aurela Kadriu: Unioni, a e mbani në mend?

Jakup Qeshmexhiu: Unionin e mbaj në mend si hotel jo. Qe besa si bujtinë e majshin katin e dytë e kanë majtën, a poshtë ka qenë restaurant edhe njana pjesë ka qenë restaurant njana pjesë ka qenën ëmbëltore. Kjo pjesa prej bustit të kryetarit Rugova ka qenë ëmbëltore, ajo tjetra ka qenë restaurant i ushqimoreve.

Aurela Kadriu: A shkojshi najhere?

Jakup Qeshmexhiu: Po, po. Kemi shku, mirë e kanë majtën. Po thom, kemi pasë përpara edukatë të punës, tash s’kemi edukatë të punës.

Aurela Kadriu: E qysh ke për juve kur u hap shtëpia e mallnave?

Jakup Qeshmexhiu: Ma së pari u hap shtëpia e mallnave e vjetra atje...

Aurela Kadriu: Kjo e reja po thom masi ka qenë ma afër.

Jakup Qeshmexhiu: Kjo e reja... po unë atëherë kom qenë si zanatli e tani shkojshim ma shpesh se çdo gja që u dufke me ble... po atëherë ka qenë kënaqësi se çka ke dashtë me ble e ke pasë në qat’ ndërtesë. Tash duhet me shku njo te Xhamia e Llapit, njo te “Tre Sheshirat”, njo knena prej Lakrishtës kërkund s’munesh me... krejt Prishtinën me shëtitë për me arritën tre-katë artikuj. Atëherë i ke pasë shtëpitë e mallnave t’gjitha kanë qenë. Bile dje a pardje isha në Administratë Tatimore kqyrsha qysh ka qenën e qysh u bo tash. Për çfarë arsye? Po tash ky farë sistemi i ri, kinse demokrat e ndryshun gjanat, se atëherë ka qenë shumë ma mirë. Po thom, që çdo gja ke mujtë me ble në shtëpi të mallnave. Tash nuk mundësh me gjetën mrena ni rruge, ni lagje për dy artikuj ose tre artikuj ku i kemi marrën, kurqyshun hiç.

Aurela Kadriu: Kur u ndërto tre rremshi, ju keni qenë në të 20-tat e juja apo?

Jakup Qeshmexhiu: Jo...

Aurela Kadriu: A keni qenë ma i ri?

Jakup Qeshmexhiu: Ma i ri kom qenë.

Aurela Kadriu: A e mbani në mend?

Jakup Qeshmexhiu: E mbaj në mend pak, po jo fort shumë. Bile e kanë pasë rretheku me ato farë teneqet... e e di që u ndërpre rruga. Rruga u ndërpre. Tani na bonën këtë rrugën knena. N’atë atë, përballë komunes kanë qenë kovaçët, farkatarët, në atë anë kanë qenë. U çelë qajo rruga kryesore, tani qikjo që ka qenë drejt kah përmendorja e tre rremshit u çel në atë anë edhe sot e kësaj dite është

qashtu. A qaty ku është përmendorja tre rremshi në dy antë ka qenë lokale të zanatlive. Ka qenë rrugë me kocka, kubza, a p'i thojnë qashtu? Se une e kom kry shkollën serbisht të mesmen tash m'vyn kohë deri t'i adaptohna.

Aurela Kadriu: E qysh vazhdoi jeta e juv mbas luftës? Çka ka ndodhë me juve?

Jakup Qeshmexhiu: Mbas luftës fillum prapë në firmën e çantave me punu, edhe fillum qaty kah pak kah pak. Djemtë, gjatë bombardimeve djemtë m'thirrën, "Dil babi, merri shoqën e çikën merrni e dilni në Maqedoni e vim iu marrim". Po mu nuk më lejojke diçka, se kisha punu 50 e kusur vite, i kisha punue me lanë shpinë e lejsha shpinë me u kallën, se magjupët ia shtijshin flakën. E plaçkitshin çka kishin me marrë edhe tani ia shtishin flakën. E m'u dhimke mundimi jem që kisha punue prej '64-tës e me lanë me ma kallë dikush nuk mujsha. Edhe nuk dola. Po kisha pasë gabu, në jetë temën kisha pasë gabu. Te kisha ditë që kom qisi populli kurrë për sy t'ballit s'kisha nejtë qitu, kurrë. Pasha shnetën kurrë s'kisha nejtë.

Aurela Kadriu: Prej cilit vit keni punu në fabrikë të çantave?

Jakup Qeshmexhiu: Prej '97-tës.

Aurela Kadriu: Deri në cilin vit?

Jakup Qeshmexhiu: Deri në 2011-tën.

Aurela Kadriu: Edhe mandej keni fillu me lokal a?

Jakup Qeshmexhiu: Tani lokalin tem e kom çelë, se filloi firmës me i ra ajo farë puna e s'mujta une me bo ma edhe e çela lokalin tem.

Aurela Kadriu: Ku e keni çelë fillimisht?

Jakup Qeshmexhiu: Ma së pari kapt me qit' lokal qitu e kom çelë. Ktu veç dy muj e gjysë kom nejtë po i ka pasë do shkallë të kqija tani e lshova ktu e përballë Shkollës "Elena Gjika" kom dalën. Aty kom nejt dy vjet e gjysë. Edhe aty mendoj pronari i saj mendoj me ndërtoe, me rrxu ata me ndërto... tani e gjeta qita e qitu kom metën qe katër vjet e gjysë.

Aurela Kadriu: Veç pak, qysh është transformu qiky zanati juv që sa vjet e punoni? Domethanë, qysh osht'... keni klienta hala? Qysh funksionon?

Jakup Qeshmexhiu: Po shiko, tash është krejt mrapsht është tu shku. Në përgjithësi, jo në zanat tem. Atëherë e kemi ditë kur është sezoni i punës, e kemi ditë kur është sezoni i papunës. Tash është e

kundërta. Kur është sezoni i punës s’vjen kërkush, kur s’o sezoni mushet plot. E përpara kemi pasë, para luftës ‘97-tën kemi punu, s’e di tash a i thoni nesesera ju po?

Aurela Kadriu: Po nesesera.

Jakup Qeshmexhiu: Nesesera kemi transportu për Vojvodinë me kamion, me kamion kemi transportu për Vojvodinë. Edhe tani mas luftës ma u ndërpre ajo me Sërbinë nuk patëm asi, fillum për qitu nëpër Kosovë. Jemi kanë furnizues të çantave për Kosovë. Vishin Prizreni, Gjakova, Peja, Ferizaji, Gilani vishin merrshin çanta te na. Po gradualisht kur fillun me ardhë kinezët, atëherë na prejtën krejt. Se kur erdhën... se na përpara kemi punu çanta për nxansa t’shkollave, merreni me mend vishin kta tregtari edhe pa i kry krejt pa i rrotullu... se na ma së pari prapë i punojmë tani i rrotullojmë.

Nuk na kanë lanë me i rrotullu, vet i merrshin i rrotullojshin. Veç a ki. Në atë kohë e punojshim ni çantë NIKEs me pare n’dorë ia jepshim 18 mark, me veresi 20 marka. Po nuk vetke, veç sa ma shumë ndami. Kur erdhën i shtinën huntë kinezt ktu, e llogaritshim vishin çantat për nxansa prej Kinës ktu tre, katër marka. E hinëm na me padronin e bonëm ni rikapitulim [kalkulim] të atyne, na veç materialin tonë katër marka. S’mujshim me nxjerrë se lehmo punën kurgjo hiç.

Edhe e lam ata ma për nxansa nuk punum. Veç secilën herë po shkon tu u shu sikurse që u shu ma tepër se gjysa, jo ma tepër se gjysa po gati 80 përqind e zanatlive që janë shu po m’doket edhe kjo po shkon tu u shu. Se te na, te na është ni e kundërt, në këtë shoqinë tonë qitash që e kemi, zanatlia nuk stimulohet, po destimulohet. Se me stimulu zanatlitë, ka pasë zanatli ma të mirtë në Jugosllavi kanë qenë zanatlitë e Kosovës. E tash në vitin 1986 kanë qenë 54 rrobaqepësa në Prishtinë, e tash asnjë s’e ki rrobaqepës me plot kuptimin e fjalës.

Aurela Kadriu: Zotni Jakup, a keni diçka me shtu që po mendoni që nuk iu kom pytë gjatë intervistës? Diçka që kishit dashtë me nda me neve?

Jakup Qeshmexhiu: Nuk po di çka me thanë, une bile e kom pa ni emision në RTK e iu pata preferu... une sikur të kisha pasë pak pushtet në dorë secilës familje i kisha thonë, çdo fmi, çdo djalë që e ka pa e çu në zanat me ia dhanë ni zanat s’e kisha lonën. Pse? Ndodhi rasti qysh na ndodhi i largun prej punës kush e kish zanatin iu ka bashkangjtitë zanatit kush s’e kish zanatin met. Mu për veti tregtia s’më shkon hiç.

Une me mbetë tregtar kisha marue se s’di me shitë, s’di me rrejt s’di asi... e e pata zanatin iu bashkangjita zanatit edhe vazhdova zanatin. E tash, ktu zanatin për veti m’kanë thonë me marr nxanës, e kisha marrë me gjithë qef se mu Zoti ma ka dhanë qat’ dijeni, po ma ka dhanë edhe me ua shkepë pasardhësve. Po kur t’i thotë t’vjen me to t’thotë, “A po ma merr djalin me punu edhe t’thotë sa po ma pagun?” Me msu djalin edhe, “sa po ma pagun?” Na kemi pagu pare për me mësu zanatin. E tash thotë, “Jo, sa p’e pagun?” “Po mirë bre zotëri, sa punon djali për me pagu une ato?”

E është puna që këto po shuhen secilën herë se nuk ka nga shteti stimulim për zanatli. Une jom si, po më thojnë pensioner, por jo, une marr, as ndihmë sociale, 75 euro si kto pare të moshës. Nuk m'i pranojnë, 50 vite përvojë pune nuk m'i pranojnë. Pos trembëdhjetë vjet të llotarisë. E është puna që tash une me marr nxanës... çantën rrallë najnjo e punoj prej fillimit. Për riparim me marrë ose për rrobaqepësi për riparime ai jetë gjysë, nuk... as nuk bohet zanatli, as s'bohet kurgjo. Për qat' arsye s'po muj me marrë kërkond.

E me kanë që të stimulon shteti, ma qet mu tatimin, i kom bo 69 vjet m'qet tatim mu a nuk ma pagun kontributin që kom punu trembëdhjetë vite. 50 s'po i llogariti po trembëdhjetë qato që i kom në librezë qato nuk po m'i pagun. E tani kti shteti çka me i thonë, i mirë a? Jo për mu jo valla aspak jo, nashta p'e teproj pak po s'kom çka me bo se jom deri qitu {tregon me duar} m'ka ardhë.

Aurela Kadriu: Shumë faleminderit për kohën zotëri Qeshmexhiu.

Jakup Qeshmexhiu: Edhe prej juve faleminderit e Zoti iu shpërbleftë, e Zoti iu ndihmoftë. Ishalla nuk e merrni rrugën e qityne që janë para juve, po vazhdoni ma mirë.

Aurela Kadriu: Faleminderit shumë.